



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

THIRRJE PËR APLIKIM

Për Pagesa Direkte – Akuakulturë për gjashtëmujorin e dytë 2017

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural do të mbështesë sektorin e mbarështimit të peshqve në hurdhë përmes Pagesave Direkte.

Kriteret që duhet t'i plotësojnë fermerët/aplikuesit që aplikojnë për Pagesa Direkte – Akuakulturë:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të shesin se paku 2500 kg peshk brenda gjashtë (6) muajve në Republikën e Kosovës;
- Llojet e pranueshme të peshkut për subvencionim janë: Trofta dhe Krapa;
- Të jetë i licencuar nga MBPZHR për zhvillimin e aktiviteteve në Akuakulturë;
- Të ketë lejen e shfrytëzimit të ujërave të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH).

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës
- Kopjen e certifikatës së biznesit
- Kopjen e certifikatës së numrit fiskal
- Konfirmimin nga banka për xhironlogarinë bankare të aplikuesit;
- Kopjen e licencës të lëshuar nga MBPZHR-ja
- Dëshmi vërtetim për obligimet e kryera ndaj Administratës Tatimore të Kosovës
- Certifikatën veterinare-shëndetësore të lëshuar nga Praktikat Veterinare të licencuara nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës (AUV)
- Dëshminë për sasinë dhe vendin e origjinës së ushqimit për peshk
- Dëshminë nga Administrata Tatimore e Kosovës për sasinë e shitur të peshkut;
- Dëshmi mbi pagesën e tatimit në pronë.

Mënyra subvencionimit:

Subvencionimi do të bëhet për kg të peshkut të shitur në vlerë prej 0.20 €.

Do të mbështeten (subvencionohen) të gjitha fermat-pronarët e hurdhave të peshkut që shesin së paku 2500 kg/peshk brenda gjashtë muajve, në Republikën e Kosovës.

Periudha e aplikimit:

Afati i aplikimit zgjatë 30 dite kalendarike dhe fillon nga data 15.01.2018 dhe përfundon me datë 15.02.2018